

Anila Omari

Mario Roques, themelues i filologjisë së teksteve të vjetra shqipe

Përmbledhje

Nëse fillimet e filologjisë shqipe mund t'i vendosim në vitin 1743, me zbulimin e 'Mesharit' të Buzukut prej Gjon Kazazit dhe riprodhimin prej tij të dy copave të tekstit në letrën dërguar Atë Gjergj Guxetës, veprimtaria e Mario Roques-it me hulumtimet e tij sistematike mbi tekstet e vjetra shqipe, me zbulimin e disa monumenteve të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe, me botimin e Fjalorit të Frang Bardhit e me zbatimin e koncepteve të filologjisë përëndimore, mund të konsiderohet me plot të drejtë themelvënëse në filologjinë moderne shqipe. Me punën dhe përpjekjet e tij këmbëngulëse për mbledhjen e teksteve të vjetra shqipe, përshkrimin dhe studimet rreth tyre, ai u bëri një shërbim të çmuar studiuesve pasardhës të gjuhës dhe historisë shqiptare, sepse pa një bazë filologjike, nuk mund të ketë studime të sakta gjuhësore e historike.

Fjalë kyçe: *filologji, tekste të vjetra shqipe, Mario Roques, analizë filologjike, botim filologjik*

Hyrje

Ishte fat për filologjinë shqipe që Mario Roques, student në École Normale supérieure e më tej në École pratique des Hautes Études, u tërhoq nga lëndët e filologjisë, që i ligjëronin asokohe filologë të shquar francezë si Joseph Bédier, Ferdinand Brunot, Édouard Tournier apo Élie Berger, Gaston Paris etj. Ata i mësuan që filologjia është arti i të lexuarit, i mësuan dhe parimet themelore të filologjisë, sidomos parimin e kërkimit të tekstit origjinal ose atë sa më afër tij, si më i besueshmi në krahasim me riprodhimet apo botimet e dorës së dytë.¹ Me shqipen Roques u afrua në vitin 1919, kur ishte emëruar drejtor i Institutit të filologjisë rumune, i krijuar me mbështetjen e qeverisë rumune. Përveç rumanishtes, të cilën e kishte mësuar me një ish shokun e tij të

¹ A. Merlin, "Notices sur la vie et les travaux de M. Mario Roques, Membre de l'Académie", në *Comptes rendus des séances de l'Académie des Inscriptions et Belles-Lettres*, Année 1961 105-2, 349-358.

shkollës, një rumun i ditur, ai shtoi edhe mësimdhënien e shqipes në këtë institut. Shkrimi i parë kushtuar shqipes, duke qenë në këtë funksion, ishte paraqitja e zbulimit të Nikolla Jorgës të dokumentit më të hershëm në gjuhën shqipe, Formulës së Pagëzimit të Pal Engjëllit, në revistën *Romania* të vitit 1926, ku jep një përshkrim të dorëshkrimit Ashburnham 1167 dhe të përmbajtjes së tij, bashkë me riprodhimin e tekstit latinisht ku gjendet formula shqip. Aty ai jep edhe leximin e tij të formulës duke korrigjuar leximin *semt* nga ana e Jorgës të fjalës së fundit të Formulës me leximin e drejtë *senit*, i cili e përfaqëson më mirë trajtën shqipe *shenjt* ose *shêjt*.²

1. Shtysa për studimin e shqipes

Interesi për tekstet e vjetra shqipe atij iu ngjall duke vënë re mangësitë në hulumtimin filologjik të dokumenteve të shqipes së vjetër, që ishin gjetur gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe që kishin pasur në dispozicion albanologët që nga Gustav Meyeri, Norbert Jokli apo Zef Skiroi. Korpuset e këtyre teksteve ishin ndërtuar pa pasur gjithmonë origjinalin apo riprodhime besnike të tij, ato nuk mbështeteshin në kërkime sistematike arkivore e bibliotekare, përshkrimet dhe analizat që u janë bërë atyre ishin të pamjaftueshme dhe në shumicën e rasteve nuk shoqëroheshin nga studime të bazuara në dokumente që mund të ndriçonin rrethanat e jetës së autorëve dhe të hartimit të veprës së tyre³. Këto janë të metat që vëren Roques në përdorimin e teksteve të vjetra shqipe nga gjuhëtarët dhe janë vërejtje që tregojnë formimin dhe përvojën e tij prej filologu të rysur drejtuar albanologëve historianë të gjuhës që nuk e kishin marrë sa duhet parasysh këtë aspekt të rëndësishëm dhe themeltar të çdo studimi gjuhësor: besueshmërinë dhe korrektesën filologjike të teksteve të përdorura në studime.

2. Konceptet dhe metodat filologjike të Mario Roques-ut

Gjendjen jo të kënaqshme dhe prapambetjen e filologjisë së teksteve shqipe Mario Roques-u e vuri në dukje edhe në hyrjen e botimit të fjalorit të Frang Bardhit, ku shprehej se, ndërsa studimet gjuhësore shqiptare kanë ecur përpara, filologjia shqipe, përkundrazi, është ende në fillimet e veta⁴. Është me interes edhe koncepti i tij për termin “filologji shqipe”, që ishte njohja, leximi, interpretimi dhe vënia në përdorim e teksteve shqipe dorëshkrime apo shtypshkrime, të cilat, duke pasqyruar gjendje gjuhësore të mëhershme, do të ndihmonin për të kuptuar më mirë gjuhën e gjallë; do të shërbenin si pika kronologjike dhe orientimi për rindërtimin e zhvillimit historik të gjuhës; dhe

² M. Roques, “Le plus ancien document de langue albanaise”, në: *Romania*, vëll. 52, nr. 205-206, 1926, 162-164.

³ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, (Geuthner: Paris, 1932), 5.

⁴ M. Roques, *Le dictionnaire albanais de 1635*, (Geuthner: Paris, 1932), 7-9.

më në fund gjuha e shkruar do të linte një gjurmë të re edhe në gjuhën e folur, sado primitive të jetë ajo⁵. Siç shihet M. Roques i dallon konceptet studime gjuhësore dhe studime filologjike, sipas kuptimit që ka termi filologji në disa vende të Evropës Perëndimore, si Francë e Itali, ku emërtimi i disiplinës lidhet gjithmonë me studimin e dokumenteve shkrimore, pra me tekstin (1. disiplinë që studion dokumentet gjuhësore dhe letrare të një kulture të caktuar ose të një qytetërimi të caktuar letrar, dhe përmes shqyrtimit të teksteve, dokumenteve e dëshmimeve, përpiqet të japë një interpretim të saktë të një problemi kritik e historik; 2. shkenca dhe teknika që ka si synim të rindërtojë një tekst në formën e tij origjinale), por jo në Angli apo Gjermani, ku termi është një koncept i përgjithshëm për të gjitha shkencat gjuhësore dhe letrare⁶.

Që në vitin 1927 Roques ka shprehur synimin e tij për të ndërmarrë botimin e teksteve të vjetra shqipe,⁷ nga të cilat *Dictionarium latino-epiroticum* i Frang Bardhit ishte vëllimi i parë. Ai premton të botojë edhe *Cuneus Prophetarum* të Pjetër Bogdanit, ku do të përdorë materialet e mbledhura mbi Andre dhe Pjetër Bogdanin⁸, si dhe ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut, të cilin e quan detyrë të ngutshme që do ta marrë vetë përsipër nëse nuk e marrin botues të tjerë. Gjithë kjo punë gjithsesi do të varej nga disponimi i mjeteve materiale. Si duket mungesa e këtyre mjeteve ka qenë arsyeja pse nuk u realizuan botimet e tjera filologjike. Si metodë botimi, për këto tekste të vëllimshme dhe të vështira ai rekomandonte riprodhimin fotomekanik si një riprodhim besnik dhe njëkohësisht të shpejtë, duke qenë se një transkriptim korrekt do të kërkonte shumë mundim dhe kohë, me rezultate të pasigurta. Botimet fotomekanike do të shoqëroheshin me një glosar sa më të plotë dhe shënime gramatikore.

Këtë metodë ai e zbatoi në botimin e *Dictionarium latino-epiroticum* të Frang Bardhit. Ai bëri një riprodhim fotografik të Fjalorit të cilin e pajisi me një studim të gjerë hyrës ku ndër të tjera jepte edhe shpjegime për grafinë e përdorur në tekstin origjinal. Sidoqë nuk ishte një botim kritik i transkriptuar në alfabetin e sotëm të shqipes për të cekur një masë më të gjerë publiku, botimi i Fjalorit i shërbente njohjes së tij nga studiuesit e shqipes, meqenëse botimi i parë i vitit 1635 tashmë ishte një gjë e rrallë. Gjithçka që dimë deri sot për jetën dhe veprimtarinë intelektuale-fetare të Frang Bardhit bazohet në studimin e Roques-ut, i cili pati mbledhur material jetësor e bibliografik në arkivat e Propagandës Fide dhe e paraqiti atë të sistemuar në hyrjen e botimit anastatik.

⁵ M. Roques, *po aty*, 8.

⁶ Shih p.sh. Fjalori i anglishtes i Oxford-it: “Dega e dijes që merret me strukturën, zhvillimin historik dhe marrëdhëniet e një gjuhe ose të gjuhëve”, Fjalori i gjermanishtes Wahrig: “Shkenca gjuhësore dhe letrare” (Sprach- und Literaturwissenschaft).

⁷ Në *Romania* LIII, 596, khs. M. Roques, *Le dictionnaire albanais de 1635*, f. 9, shënim.

⁸ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, 6.

Në studimin që i paraprin fjalorit gjejmë të dhëna të rëndësishme për historinë, sidomos atë kishtarë, gjeografinë, përbërjen etnike dhe fetare të popullsisë së dioqezës së Sapës ku ka vepruar Bardhi, për familjen e Bardhejve dhe klerikët e lartë që ka nxjerrë ajo, për jetën dhe veprën e Frang Bardhit dhe në veçanti më gjerësisht për Fjalorin e tij latinisht-shqip: historikun, përmbajtjen, sistemin grafik. Ai paralajmëron edhe për një vëllim të dytë të Fjalorit të Frang Bardhit, i cili do të përmbante një tregues alfabetik të plotë të fjalëve shqipe të Fjalorit, i cili gjithashtu nuk u realizua dhe vetëm në vitin 2008 e pa dritën e botimit në formën e konkordancës elektronike të Fjalorit, të përpunuar nga Bardhyl Demiraj në edicionin e tij kritik të kësaj vepre të parë leksikografike të shqipes.

Në shtesat e hyrjes së Fjalorit, Roques riprodhoi edhe fjalorthin e Arnold von Harffit të vitit 1479 si dhe disa fragmente nga relacioni i Pjetër Mazrekut, argjipeshkëv i Tivarit, i vitit 1633, që e kishte zbuluar vetë në kërkimet arkivore në Romë, në të cilat përmenden glosa shqipe e emra vendesh, dhe një listë prej 32 fjalësh shqipe që Mazreku mendonte se rridhnin nga italishtja.

Shërbimin më të madh albanologjisë M. Roques-u ia bëri me hulumtimet sistematike dhe afatgjata rreth teksteve të vjetra shqipe, rezultatet e të cilave i botoi në vëllimin *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris 1932. Në këtë vëllim ai ndërtoi listën e plotë të teksteve të vjetra shqipe nga shekulli XV deri në fillim të shekullit XVIII, një pjesë të mirë të të cilave e zbuloi vetë në arkivat e Vatikanit dhe të Propaganda Fide-s,⁹ listë që është e vlefshme edhe në ditët tona. Ndër këto zbulime vlen të përmenden dy nga veprat e Budit: kopja e vetme e botimit të parë të Doktrinës së Krishterë të Pjetër Budit, të vitit 1618, e gjetur prej tij në Bibliotekën e Vatikanit¹⁰, e cila nuk njihej deri në atë kohë dhe si botim i parë i veprës së Budit mbahej ai i vitit 1636, dhe Rituali roman me shtojcën e një fashikulli me shpjegimet e meshës katolike: *Kush thotë meshë këto kafshë i duhetë me shërbyem*. Gjeti gjithashtu dhe dy kopje të tjera të *Speculum Confessionis* nga i cili njihej një kopje e vetme¹¹. Ai jep përshkrimin fizik dhe përmbajtjen e të gjitha dokumenteve, dorëshkrime apo shtypshkrime që ka përfshirë në libër, duke sjellë edhe të gjitha të dhënat që ka mundur të mbledhë rreth tyre dhe autorëve të tyre, shoqëruar me vërejtje të mprehta vetjake me vlerë të qëndrueshme. Me skrupulozitet dhe korrektesë shkencore ai rreshton të gjithë ekzemplarët që ka mundur të gjejë për tekstet e shtypura dhe vendndodhjen e tyre, për t'u ardhur në ndihmë studiuesve të mëvonshëm që do të merren me studimin apo botimin e këtyre teksteve.

⁹ Shih F. Fishta, "Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë", në *Buletin i USHT*, n.3, Tiranë, 1962, f. 211.

¹⁰ M. Roques, *Recherches...*, vep. cit., f. 22.

¹¹ M. Roques, *Recherches...*, vep. cit., f. 27.

3. Gjetjet rreth ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut

Kontributin më të rëndësishëm në studimin e teksteve të vjetra shqipe M. Roques-u e shënoi me përshkrimin dhe analizën filologjike të librit të parë shqip, ‘Mesharit’ të Buzukut. Për shkak të peripecive e vonesave në gjetjen, zhdukjen e përkohshme e rigjetjen e këtij monumenti të paçmuar të shkrimit të shqipes, e më tej të trazirave që shoqëruan jetën shqiptare pas pavarësisë¹², libri iu nënshtrua interesit dhe hulumtimit të studiuesve vetëm në vitet ’20.¹³ Roques-u është i pari që jep përshkrimin fizik të vëllimit, paraqitjen e përmbajtjes së tij, të karaktereve të shtypit, duke përshkruar 5 grafemat e veçanta, jolatine të alfabetit të Buzukut, dhe duke bërë krahasime me alfabetet e ngjashme të bashkësive etnike fqinje me të cilat Buzuku me siguri do të ketë qenë në kontakt.¹⁴ Shkronjat jolatine që i ka marrë nga alfabetet sllave të katolikëve të Bosnjës e të Kroacisë, Buzuku i përdori me vlera të ndryshme nga ato që kishin në të folmet sllave, psh shenja grafike <y> te Buzuku ka tri vlera të ndryshme fonetike, siç e ka shpjeguar Çabej: [u], [y] dhe [u_e]¹⁵ (transkriptuar me [u] te Çabej). Në disa raste shkronjat e Buzukut kanë një formë të veçantë, p.sh. shenjën <ε> me vlerën e z, si te <εot>, ai e përshkruan si <3> (zemlja) sllave të kthyer majtas, që autori e ka hasur në dokumente kroate. Meqenëse librit i mungonte frontespici, Roques-u u përpoq të përcaktonte sa më afër vendin e botimit të veprës, që sipas gjithë indikacioneve duhet të ishte Venecia, si vendi ku shtypeshin edhe shkrime me cirilikën e Bosnjës, por edhe nga letra italiane e librit. Karakteret latine gjithashtu ishin të llojit të përdorur në Venecie, dhe shkronjat e veçanta, katër prej tyre, ai i ka gjetur në një libër të rrallë të shtypur në alfabetin bosnjak në Venecie më 1571. Edhe përmbajtja e këtij libri i afrohet atij të Buzukut në pjesën e parë të tij, që paraqitet si një libër orësh (horologium), me Oficjen e Zonjës, Shtatë psalmet pendestare, Litanitë e shenjtëve dhe Oficjen e të vdekurve, modele që kanë ekzistuar edhe para vitit 1555 në katolikët e Bosnjës, nga të cilat Roques sjell një indikacion bibliografik me peshë, të vitit 1512, shtypur në Venecie.¹⁶ Këto ndikime nga fqinji verior e shtynë Roques-un të përsiaste edhe një motivim të ngjashëm në idenë për t’u dhënë bashkëkombasve të vet një libër orësh të hartuar në gjuhën kombëtare, gjë që do të ishte me rëndësi edhe për historinë e përdorimit

¹² Shih A. Omari, “Kontributi i ‘Hyllit të Dritës’ në studimet filologjike shqiptare”, në *Hylli i Dritës*, numër jubilar, 1-2, 2013, f. 67v.

¹³ D. N. Gazulli, “Gjurmime mbi veprën e Dom Gjon Buzukut”, në *Hylli i Dritës*, V (1924), nr. 10. Më vonë edhe Jokli, po në këtë revistë: N. Jokl, “Gjyqi i linguistëve të huej për rreth librit të Buzukut”, në *Hylli i Dritës*, VI (1930), nr. 3, f. 143-154.

¹⁴ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, vep. cit., f. 12.

¹⁵ E. Çabej, “Hyrtje”, në *Meshari i Gjon Buzukut (1555)*, I, Tiranë, 1968, f. 50-52 e vijim.

¹⁶ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, vep. cit., f. 15.

liturgjik të gjuhëve kombëtare në Kishën katolike. Çabej e ka shtjelluar më tej një mendim të tillë në studimin e tij introduktiv për ‘Mesharin’ e Buzukut. Ai e paraqet si mundësi që autoriteti kishtar që direkt ose indirekt e ngarkoi këtë prift shqiptar të hartonte këtë veprë të ketë qenë i shtyrë nga vullneti për të ngritur në Shqipëri gjuhën e vendit në rangun e një gjuhe liturgjike. Këtë hipotezë ai e arsyeton me disa argumente: së pari me kushtet politiko-fetare të Reformës që çuan në lejimin e përdorimit të gjuhëve popullore në shkrimet fetare; së dyti, me lejimin ende më herët, që në shek. 13, të ushtrimit të liturgjisë në gjuhën popullore sllave në vendet katolike të Ballkanit perëndimor, një lëshim që ua kishte bërë kroatëve të veriut papa Inoçenti IV, dhe së treti, me rrethanat e pushtimit turk dhe nevojën për forcimin e fesë në Shqipëri, ashtu siç ndodhi edhe më vonë me botimin e veprave të Budit nga Selia e Shenjtë.¹⁷

Mario Roques ndriçoi edhe aspekte të tjera të librit të Buzukut dhe të personalitetit të tij, duke shqyrtuar me akribi shkencore përmbajtjen e veprës. Ai vuri re praninë e tre shenjtoreve françeskanë në Litanitë e shenjtëve të Buzuku që zakonisht nuk hasen në litanitë e kësaj periudhe, por gjenden në librat e orëve nga Bosnja të shtypura në Venecie në 1512 e 1571. Dy shenjtore të tjerë janë zëvendësuar me shenjtë françeskanë me të njëjtin emër, si Shën Antoni i Padovës dhe Shën Bernardini. Këto fakte hagjiografike, së bashku me përbërjen e pazakonshme të librit të Buzukut, një kombinim i librit të orëve, mesharit, elementeve të katekizmit dhe ritualit, që, sipas kërkimeve të Roquesut, gjen përkim në disa libra orësh me prejardhje françeskane nga fundshekulli XIV, e kanë çuar autorin në përfundimin se Buzuku në hartimin e librit të tij është frymëzuar nga urdhri françeskan.¹⁸ Çabej jo vetëm e mbështet këtë përfundim, por e shtyn më tej lidhjen e Buzukut me këtë urdhër mjaft të përhapur në Shqipëri qysh para fillimit të veprimtarisë së misioneve françeskane nga viti 1634¹⁹, duke shprehur mendimin se ai mund të jetë shkolluar të françeskanët, madje të ketë qenë pjesëtar i urdhrit terciar të françeskanëve.²⁰

Më tej Roques përpiket të identifikojë vendin e shërbimit kishtar të Buzukut duke u nisur nga fjalët e tij në kolofon: *u tue ëmbajturë një klishë*, e cila mund të ishte jo medoemos në Shqipëri, po në çdo vend ballkanik me prani të shqiptarëve ku vepronte Kisha romane dhe ku priftërinjtë mund të zhvendoseshin pa pengesë nga një vend në tjetrin, ashtu siç patën bërë Budi

¹⁷ E. Çabej, “Hyrje”, në ‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), I, vep. cit., f. 24.

¹⁸ M. Roques, *Recherches sur les anciens textes albanais*, vep. cit., f. 16.

¹⁹ Shih p.sh. Cherubino da Trento, “Relatione d’alcune cose notabili ocourse nella Missione”, në: *Studime Filologjike*, nr. 1-2, 2021, f. 69 vv., dorëshkrim i gjetur dhe i transkriptuar nga Lucia Nadin.

²⁰ E. Çabej, “Hyrje”, në ‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555), I, vep. cit., f. 24.

apo Bogdani, madje edhe te shqiptarët e Dalmacisë apo të Italisë. Ai jep edhe një detaj me shumë interes për t'iu përafuar vendit të shërbimit të tij në të njëjtin qytet ku u shtyp edhe libri i tij, pra Venecies, me të cilën shqiptarët kishin lidhje të hershme: liturgjia kushtuar Shën Jobit, kulti i të cilit nuk është shumë i përhapur, por ekziston në Venecie, ku është edhe kisha e këtij shenjti në lagjen Cannareggio. Ky është një indikacion që prof. Lucia Nadin e ka përdorur si një ndër argumentet për të përcaktuar Venecien si vendbanimin dhe vendshërbimin e Buzukut,²¹ mendim që është miratuar nga albanologët në radhë të parë nga ky argument i pranisë së Shën Jobit në litanitë e Shenjtëve të Buzukut.²² (Këtu duhet thënë, në parantezë, se Shën Jobi festohet në vendet katolike të Ballkanit Perëndimor, si Kroaci e Slloveni, p.sh. kisha e Shën Jobit në Sinja Gorica, Slloveni)

Ndikimi venecian te Buzuku vihet re edhe në grafinë e tij: ai shënon frikativën e shurdhët postalveolare /sh/ me shkronjën <s> po ashtu si Formula e Pagëzimit në *spertit senit*, dhe, siç e vuri re Jokli²³, kjo grafi mund të jetë një ndikim venecian, për shkak të mosdallimit në shqiptim të /s/ dhe /ʃ/ në atë dialekt. Prandaj Roques-u e cilëson Buzukun “ende një përfaqësues të Shqipërisë mesjetare, të depërtuar nga ndikime veneciane”.²⁴ Çabej, duke miratuar këtë mendim të tij, e vlerëson në një kontekst më të gjerë kohor e në lidhje me autorët e tjerë dhe e konsideron këtë shkrimtar se qëndron në kapërcyell nga Mesjeta në kohën e re, nga Arbënia paraturke kristiane në Shqipërinë turke të islamizuar²⁵.

Përfundime

Nëse gjurmojmë historikisht fillimet e filologjisë shqipe, ato mund t'i gjejmë në vitin 1743,²⁶ me zbulimin e ‘Mesharit’ të Buzukut prej Gjon Kazazit

²¹ L. Nadin, *Shqipëria e rigjetur – zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI – Albania ritrovata – recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del cinquecento veneto*, (Tiranë: Onufri, 2012).

²² J. Matzinger, “L'ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale ('Messale') di Gjon Buzuku”, në *Hylli i Dritës* 4, 2010, 54-70.

²³ N. Jokl, “Gjyqi i linguistëve të huejë për rreth librit të Buzukut”, *Hylli i Dritës*, VI, nr. 3, (Shkodër: Shtypshkroja Françeskane, 1930), f. 10.

²⁴ M. Roques, *Recherches*, vep. cit., f. 17v.

²⁵ E. Çabej, “Gjon Buzuku dhe gjuha e tij”, në *Buletin për Shkenca Shoqërore*, I-IV, 1555, ribotuar në E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell, epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, (Tiranë Sh.B. Çabej, 2006).

²⁶ Khs. B. Demiraj, “Zur Entdeckung von Buzukus ‘Missale’ in der ersten Hälfte des 18. Jh.s”. Në *Nach 450 Jahren. Buzukus Missale und seine Rezeption in unsere Zeit. Akten der 2. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung in München - 14.-15. Oktober 2005*, në serinë “Albanische Forschungen” vëll. 25, (Wiesbaden: Harrassowitz, 2007), 289 – 299.

dhe riprodhimin prej tij të dy copave të tekstit në letrën dërguar Atë Gjergj Guxetës, e vetëm mbas dy shekujsh me rizbulimin e librit të parë shqip nga Pal Skiroi më 1909 dhe punën filologjike të kryer prej tij mbetur në dorëshkrim, për fat të keq. Por Mario Roques me hulumtimet e tij sistematike mbi tekstet e vjetra shqipe, me zbulimin e disa monumenteve të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe, me botimin e Fjalorit të Frang Bardhit e me zbatimin e koncepteve të filologjisë perëndimore, mund të konsiderohet me plot të drejtë themelues i filologjisë së teksteve shqipe. Me punën dhe përpjekjet e tij këmbëngulëse për mbledhjen e teksteve të vjetra shqipe, përshkrimin dhe studimet rreth tyre, ai u bëri një shërbim të çmuar studiuesve pasardhës të gjuhës dhe historisë shqiptare, sepse pa një bazë filologjike, nuk mund të ketë studime të sakta gjuhësore e historike dhe Mario Roques, siç shprehet në hyrjen e ribotimit të Fjalorit të Bardhit, e ka për nder t’u ketë hapur rrugën punëtorëve të albanologjisë.²⁷

Bibliografi

- Çabej, Eqrem. 2006. “Gjon Buzuku dhe gjuha e tij”. Në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, I-IV, 1555, ribotuar në E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell, epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*. Tiranë: Sh.B. Çabej.
- _____. 1968. “Hyrje”. Në *‘Meshari’ i Gjon Buzukut (1555)*, I. Tiranë: Universiteti i Tiranës, IGJL.
- da Trento, Cherubino. 2021. *Relatione d’alcune cose notabili ocourse nella Missione*. Në *Studime Filologjike*, nr. 1-2, 69-162, dorëshkrim i gjetur dhe i transkriptuar nga Lucia Nadin.
- Demiraj, Bardhyl. 2007. “Zur Entdeckung von Buzukus „Missale“ in der ersten Hälfte des 18. Jh.s”. Në *Nach 450 Jahren. Buzukus Missale und seine Rezeption in unsere Zeit. Akten der 2. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung in München - 14.-15. Oktober 2005*, ed. B. Demiraj, “Albanische Forschungen” vëll. 25, 289 – 299. Wiesbaden: Harrassowitz.
- Fishta, Filip. 1962. “Mario Roques për filologjinë, kërkimet arkivale dhe historike të vendit tonë”. Në *Buletin i USHT*, n.3. Tiranë.
- Gazulli, Dom Nikollë. 1924. “Gjurmime mbi veprën e Dom Gjon Buzukut”. Në *Hylli i Dritës*, V, nr. 10.

²⁷ “je tiendrais à l’honneur de leur avoir ouvert la voie”, në: M. Roques, *Le dictionnaire albanais de 1635*, (Geuthner: Paris, 1932) f. 9.

- Jokl, Norbert. 1930. “Gjyqi i linguistëve të huejë per rreth librit të Buzukut”. Në *Hylli i Dritës*, VI, nr. 3, 143-154. Shkodër: Shtypshkroja Françeskane.
- Matzinger, Joachim. 2010. “L’ordine dei nomi dei santi nella litania di Ognissanti nel Manuale Pastorale („Messale“) di Gjon Buzuku”. Në *Hylli i Dritës* 4, 54-70. Shkodër: Shtypshkroja Françeskane.
- Merlin, Alfred. 1961. “Notices sur la vie et les travaux de M. Mario Roques, Membre de l’Académie”. Në *Comptes rendus des séances de l’Académie des Inscriptions et Belles-Lettres*, Année 1961, 105-2, 349-358.
- Nadin, Lucia. 2012. *Shqipëria e rigjetur – zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në Shek.XVI – Albania ritrovata – recuperi di presenze albanesi nella cultura e nell’arte del cinquecento veneto*. Tiranë: Onufri.
- Omari, Anila. 2013. “Kontributi i ‘Hyllit të Dritës’ në studimet filologjike shqiptare”. Në *Hylli i Dritës*, numër jubilar, 1-2, 63-74.
- Roques, Mario. 1926. “Le plus ancien document de langue albanaise”. Në *Romania*, vëll. 52, nr. 205-206, 162-164.
- _____. 1932. *Le dictionnaire albanais de 1635*. Geuthner: Paris.
- _____. 1932. *Recherches sur les anciens textes albanais*. Geuthner: Paris.

SUMMARY

Mario Roques, founder of the philology of old Albanian texts

The article aims to highlight the contributions of the French philologist, Mario Roques, to the philology of ancient Albanian texts.

After outlining Roques' academic background, the article delves into the motivations behind his interest in ancient Albanian texts, his conceptual approach to Albanian philology, and the methodologies he employed to publish these texts. Additionally, it emphasizes his specific contributions, such as his publication of Frang Bardhi's Latin-Albanian Dictionary. This publication included an introductory study enriched with data from Roques' personal archival research. He also conducted systematic research on ancient Albanian

texts, which was published in the volume “Recherches sur les anciens textes albanais” (Paris, 1932). This work provides a comprehensive list of ancient Albanian texts from the 15th century to the early 18th century, detailing the physical description and content of all documents included, along with valuable personal commentary on the texts and their authors.

The article further explores Roques’ discoveries concerning the first Albanian book, the ‘Missal’ by Gjon Buzuku. It highlights his significant findings regarding numerous previously unknown aspects of this work and its author, including the location of the work’s publication, the origins of the special characters in the Buzuku alphabet, the reasons for composing the liturgical work in the vernacular, the location of Buzuku’s church service, and various influences evident in his work, among other aspects.

If we trace the beginnings of Albanian philology to 1743, marked by Gjon Kazazi’s discovery of Buzuku’s ‘Missal’ and his reproduction of excerpts in a letter to Father Giorgio Guzzetta, then Mario Roques’ systematic research on old Albanian texts, his discoveries of significant monuments in old Albanian literature, his publication of the *Blanchus Dictionary*, and his application of Western philological concepts can rightfully be considered the foundation of modern Albanian philology. Through his relentless pursuit to gather, describe, and study ancient Albanian texts, Roques provided invaluable resources to subsequent researchers of the Albanian language and history. His work laid a crucial philological foundation necessary for accurate linguistic and historical studies.